



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 142/2019

PËR NDRYSHIM TË RENDIT TË DITËS NË SEANCË PLENARE

Në mbështetje të nenit 31 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Të shtohen si pikë e rendit të ditës të seancës plenare të datës 18.12.2019 çështjet e mëposhtme:

a) Akt normativ nr. 8, datë 16.12.2019, “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”;

b) Akt normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miraturar datë 18.12.2019